



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 19.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Admir Belishta.		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Admir Belishta		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqtar/Kryetar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor, Korçë.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor që ajo të shtyhej për shqyrtim të mëtejshëm.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Në fund të seancës dëgjimore trupi gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën vetëm për shpalljen e tij në datën 21.12.2018, ora 09:00.		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqësore (emrat)	Kryesues: Olsi Komici, Relator: Genta Tafa(Bungo), Anëtar: Lulzim Hamitaj.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN): zj. Elka Ermenkova		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Subjekti i rivlerësimit u paraqit pa praninë e një mbrojtësi ligjor.		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Amilda Celami		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u lejuan media, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, qytetarë të interesuar. Numri total i të pranishmëve varioje 10 persona.		
Media e pranishme:	Gazetarë të mediave ishin të pranishëm. (Vetëm një operator)		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	KPK e bazoi gjykimin mbi tre kriteret (Vlerësimi pasurisë, Kontrolli i figurës, Vlerësimi i aftësive profesionale)		
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?

D1. Pasuria	Raporti i ILDKPKI-së pasqyron: Deklarim i pasaktë, s'ka burime të ligjshme financiare, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, deklarimi rremë , subjekti nuk ndodhej ne kushtet e konfliktit të interesit.	Raporti nga ILDKPKI	Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës, aftësiwe profesionale, relatori i çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në të dhënat e ardhura nga ILDKPKI, DSIK, Inspektorati i KLD, hetimi administrativ i KPK-së, të dhënat e marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova.
	Në bazë të hetimit të thelluar të KPK-së rezultojnë: 1. Ap.banimi 107m2 në Korçë, blerë më 22.09.2009. Në lidhje me këtë pasuri subjekti nuk ka deklaruar burimin për blerjen e apartamentit dhe për mobilimin e tij në shumën rreth 6 milion lekë. Për vitin 2009 ka mungesë të ardhurash. 2. Shtëpi në Peras (Maliq) 130m2 përfituar nga familja bujqësore, 62.4m2 pjesa takuese. E Legalizuar më 26.12.2014. Deklarim i rremë lidhur me mënyrën e përfitimit. Në lidhje me këtë pasuri subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit dhe mospërputhje të vlerës 2.6 milion që kanë shërbyer për rregullime dhe mobilim. KPK dyshon për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm. 3. Tokë bujqësore 2.970m2 në Peras(Maliq) përfitues sipas ligjit nr.7501"Për tokën". Në lidhje me këtë pasuri deklarimi është cilësuar i saktë. 4. Benz220 blerë në vitin 2012. Në lidhje me këtë pasuri cilësohet mungesë e burimit të pasurisë, fiktivitet në mënyrën e bërjes, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie. 5. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuritë në lidhje me bashkëshorten e tij E.B e cila ka rezultuar përfituese nga ligji nr. 7501"Për tokën"e një sipërfaqe trualli dhe shtëpi. 6. Analiza financiare: rezultojnë mungesë të ardhurash në lidhje me shpenzimet e bëra ndër vite.	Relatori i çështjes	
		Mbrojtja	
	-Lidhur me ap. 107m2, deklarohen që është blerë me burime financiare të mjaftueshme. Si të ardhura për krijimin e saj thekson shëputjen nga trangu familjar në vitin 2004, përfitim 1.2 milion lekë dhe kursime nga puna. Në vitin 2009 thekson që ka marrë hua 1 milion lekë. Vërteton që ka mobiluar pjesërisht shtëpinë në shumën 6 milion lekë dhe pjesën tjetër të parave e ka kthyer një vit më vonë. -Lidhur me shtëpinë 62.4m2 cilëson se vetëm e ka regjistruar , pasi kjo ka qenë një pronë e poseduar nga familja e tij prej 40 vitesh. -Lidhur me analizën financiare, subjekti i rivlerësimit cilëson se në vitet 2007 dhe 2008 i janë llogaritur udhëtime private kur ndërkohë kanë qenë udhëtime zyrtare. Ndërsa për udhëtimet në SHBA thekson se kanë qenë udhëtime pa shumë shpenzime pasi ka qëndruar tek njerëzit e njohur të tij, nga ku kërkojë që mund të sillte edhe dëshmitarë për këtë. Në lidhje me automjetin Benz deklarohen që nuk e njeh personin që ia ka blerë, në shumën 600 mijë lekë(pagesa cash). -Lidhur me pasurinë e bashkëshortes, e cilësoi si harrësë dhe neglizhencë nga ana e tij megjithëse nuk kishte përfituar asgjë pasi kishte hequr dorë me vullnetin e saj. Në fund të fjalës së tij subjekti i rivlerësimit theksoi se burimi i të gjithë pasurisë së tij vjen nga: kursimet, paga si pedagog, ekspertizat, botimet, të ardhura të përfituara nga familja.	Subjekti	
		Ankesa nga publiku	
	ONM		

D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	DSIK kishte paraqitur pranë KPK-së dy raporte të ndryshme. Raporti i rishikuar e kishte cilësuar subjektin e rivlerësimit z.Admir Belishta si të “Papërshtatshëm” për vazhdimin e detyrës.	Të dhëna nga raportet e DSIK	
	KPK në hetimin e thelluar të tij ka konkluduar se informacioni në lidhje me raportin e rishikuar nga DSIK ishte i plotë dhe me përmbajtje të elementëve të kërkuar.	Relatori	
		Mbrojtja	
		Subjekti	
	4 ankesa pranë KLD-së	Ankesa nga publiku	
	ONM		
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Raporti mbi kontrollin e aftësive profesionale konkludon: Stil i njëjtë në përpilimin e akteve, organizim strukturor mbi mesataren, njohuri të konsoliduara, vendime të qarta me strukturë të standardizuar.	Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	
	Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, janë marrë në shqyrtim 3 dokumente ligjorë të përpiluar nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e 5 dosjeve rastësore. Për periudhën 01.01.2007- 31.12.2009 ka 4 vendime të censuruara nga Gjykata e Apelit për shkak të shkeljes së procedurës, interpretim i gabuar i ligjit të provave. Edhe pranë KPK-së janë depozituar 4 denoncime në lidhje me subjektin të cilat kanë rezultuar të pabazuara.	Relatori	
		Mbrojtja	
	z.Admir Belishta argumentoi se respektonte vendimet e Gjykatës së Apelit, por ai cilësoi se kishte zbatuar ligjin dhe se vendimet ishin marrë nga një trupë prej 3 anëtarësh.	Subjekti	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z.Admir Belishta, kryetar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Korçë u paraqit e rregullt, duke respektuar kriteret për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Pati kontestime, pyetje nga anëtarët e trupës gjyqësore, kundërshtime nga subjekti i rivlerësimit. Relatorja e çështjes dhe anëtari Z. Hamitaj i drejtuan pyetje subjektit lidhur me pasurinë dhe i cilësuan deklaratimet e tij si të mjegullta. Gjatë shqyrtimit të seancës dëgjimore u trajtuan tre kriteret e gjyqimit të procesit të rivlerësimit. z. Belishta pohoi se ishte njohur dhe kishte marrë në dorëzim materialet e dosjes. Subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe trupi gjyqësor pohoi që ishin marrë në shqyrtim provat e sjella. Ndaj tij ishin adresuar disa ankesa(4 pranë KLD-së dhe 4 pranë KPK-së), të cilat relatorja e çështjes i cilësoi si të pabazuar në prova dhe fakte. Ankesat thjeshtë u përmendën duke mos u trajtuar në detaje dhe duke mos cituar as natyrën e tyre. Trupi gjyqësor në asnjë moment nuk shkeli rregullat e etikës, profesionalizmit dhe nuk u vërejtën probleme të kësaj natyre. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të mos kishte mbrojtës por nuk u konstatua cënimi i së drejtës për mbrojtje efektive nga ana e trupit gjyqësor si dhe nuk pati pretendime nga ana e subjektit. Nuk u konstatua asnjë shkelje, paragjykim apo presione të ndryshme gjatë seancës. . Përmasat e sallës në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve) garantonte respektimin e plotë të standardeve të një seance publike.		